

L I G J
Nr.8455, datë 4.2.1999

**PËR NJË TRAJTIM TË VEÇANTË TË FAMILJEVE TË PILOTËVE QË HUMBASIN
JETËN NË PËRMBUSHJE TË DETYRËS GJATË FLUTURIMIT**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Pjesëtarët e familjes në ngarkim të pilotit që për shkak të detyrës gjatë fluturimit humbasin jetën, përfitojnë pension familjar në masën 100 për qind të pagës referuese bazë mujore të muajit më të fundit kalendarik të shërbimit, pavarësisht nga periudha e sigurimit të të ndjerit.

Pagë referuese bazë mujore të muajit më të fundit kalendarik të shërbimit është paga e muajit më të fundit sipas legjislacionit në fuqi.

Pjesëtarët e familjes dhe kushtet në të cilat ata përfitojnë këtë pension janë ato të përcaktuara në nenin 40 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.

Pjesëtarët e familjes që gëzojnë një pension tjetër kanë të drejtë të zgjedhin pensionin më të favorshëm.

Këshilli i Ministrave rrit pensionet familjare të mësipërme në një masë të caktuar, sa herë rriten dhe pensionet e tjera

Neni 2

Shpenzimet për pensionet familjare të mësipërme për vitin 1999 përballohen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Caktimi dhe administrimi, si dhe dhënia e pensioneve bëhet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

Neni 3

Pjesëtarëve të familjes, në ngarkim të pilotit që për shkak të detyrës gjatë fluturimit humbet jetën, u jepet një shpërblim i menjëhershëm në masën 5(pesë) paga bazë mujore të muajit të fundit kalendarik që ka marrë i ndjeri. Ky shpërblim përballohet dhe jepet nga Ministria e Mbrojtjes.

Neni 4

Fëmijëve të pilotëve që humbasin jetën gjatë fluturimit në përmbushje të detyrës, shteti u garanton bursë, kur përfitojnë të drejtën e studimit, sipas kriterëve të përcaktuara në akte ligjore dhe nënligjore.

Neni 5

Ngarkohen Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria

e Arsimit dhe Shkencës të nxjerrin aktet e tjera nënligjore në bazë e për zbatimin e këtij ligji.

Neni 6

Efektet financiare, për pension familjar sipas nenit 1 për pilotët e shpallur “Dëshmor të Atdheut”, fillojnë nga dita e shpalljes së tyre.

Neni 7

Për këtë kategori ushtarakësh, nenet 16 dhe 17 të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të armatosura të Republikës së Shqipërisë” nuk zbatohen.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2315, datë 11.2.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**